



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Beni Construction shpk" të datës 20.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (mbikalimi dhe nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën A - bashkëfinancim me MMPHI" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Beni Construction shpk" të datës 20.08.2026 kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (mbikalimi dhe nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën A - bashkëfinancim me MMPHI" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1.
- II. AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Beni Construction shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 20.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër ftesës për ofertim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urës (mbikalimi dhe nënkalimi për vetura dhe automjete) në Veternik mbi rrugën A - bashkëfinancim me MMPHI" me nr. të prokurimit 616-26-6502-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi nr. 1:

Parashtrojmë se Kërkesa nr. 1, nga pikat 9.1&9.2 të FTD përbën kërkesë diskriminuese, e cila redukton dhe eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë, si dhe që diskriminon në dëm, ose në të mirë të një, ose më shumë operatorëve ekonomikë:

9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	Dëshmitë e kërkuar dokumentare:
	Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të ngjashme me natyrën e kontratës në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë si (projekte të infrastrukturës ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve, kanalizimit, ujësjellësit) në vlerë prej së paku 15,000,000.00. € Min, një nga projektet duhet të jetë ndërtimi i një ure me vlerë jo më pak se 3,000,000.00 Euro.	Dëshmitë 1. Aneksi 7.1 DT-së. Listën me të cilën specifikohen të gjitha punët kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik që janë kryer në tri vitet e fundit para publikimit të këtij njoftimi për kontratë. Listës duhet të bashkëngjiten kur puna është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohet referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë. Në referencë duhet që të jetë shënuar vlera e realizimit të punëve. Kur puna është bërë për një blerës privat, kopja e çdo dokumenti të nënshkruar

Konsiderojmë se kërkesa që një nga projektet referuese të jetë konkretisht ndërtimi i një ure me vlerë minimale prej 3,000,000.00 € është një kërkesë shumë specifike dhe kufizuese, e cila mund të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në konkurrencën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë.

Nga vetë përshkrimi i punëve të ngjashme, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si përvojë relevante projekte të infrastrukturës, përfshirë ndërtimin, rehabilitimin apo rikonstruktimin e rrugëve, kanalizimeve dhe ujësjellësve. Në këtë kuadër, kërkesa e veçantë për një projekt të përfunduar të ndërtimit të urës me vlerë jo më pak se 3,000,000.00 € paraqet një ngushtim të mtejshëm të kriterit, duke kërkuar një lloj shumë specifik të referencës, pavarësisht nga fakti se kapaciteti dhe përvoja e Operatorit Ekonomik mund të dëshmojnë përmes projekteve të tjera të infrastrukturës me vlerë dhe kompleksitet të krahasueshëm.)

Pretendimi nr. 2:

Parashtrojmë se Kërkesa nr. 2.3 – nga pikat 9.1&9.2 të FTD përbën kërkesë diskriminuese, e cila redukton dhe eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë, si dhe që diskriminon në dëm, ose në të mirë të një, ose më shumë operatorëve ekonomikë:

Kërkojmë rishqyrtimin e kërkesës për një (1) Inxhinier të diplomuar, apo Master në drejtimin Elektroteknik dhe Automatikë, me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Kërkojmë të sqarohet përse kërkohet në mënyrë specifike kombinimi i drejtimit Elektroteknik dhe Automatikë dhe nëse funksionet e parapara për këtë pozitë mund të kryhen nga një Inxhinier Elektroteknik, me përvojën përkatëse.

Nëse detyrat e inxhinierit kanë të bëjnë me punë të instalimeve elektrike, sistemeve energjetike dhe mbikëqyrjen e punëve elektrike, konsiderojmë se kërkesa për profilin shtesë Automatikë është e panevojshme dhe kufizuese.

Pretendimi nr. 3:

Parashtrojmë se Kërkesa nr. 4 – Lista e mjeteve, nga pikat 9.1&9.2 të FTD përbën kërkesë diskriminuese, e cila redukton dhe eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomikë, si dhe që diskriminon në dëm, ose në të mirë të një, ose më shumë operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, kërkohen sasi shumë të mëdha të pajisjeve, shpesh me specifikime tepër të detajuara dhe në disa raste për makineri me funksion të njëjtë, ose të ngjashëm.

Për pasojë, kërkojmë rishqyrtimin e listës së makinerive, pasi disa kërkesa janë të përsëritura, të ngjashme në funksion, ose tepër specifike dhe mund të kufizojnë konkurrencën.

Në veçanti, kërkojmë të rishikohen:

- Buldozerët 29 ton dhe 20 ton – kanë të njëjtin funksion; kërkohet arsyetim për kërkesën e të dy kategorive.
- Cilindri vibruës 20 ton dhe cilindri me dhëmbëza 20 ton – duhet të sqarohet nevoja për të dyja makineritë.
- Cilindrat Gomë-Hekur 9 ton dhe 4 ton – kryejnë të njëjtin funksion; pesha e ndryshme nuk duhet të jetë kufizuese.
- Eskavatorët 53 ton, 24 ton dhe 18 ton – kërkesa për pesha specifike duhet të lidhet me nevojën reale të projektit dhe të lejohen makineri ekuivalente.
- Ngjeshësi, frezi, çekiçi dhe prerësja e asfaltit për eskavator – janë pajisje shtesë që montohen në bager; kërkojmë të sqarohet domosdoshmëria e secilës.
- GPS, kamera dhe sistemet laserike – janë specifikime shumë të veçanta dhe kërkojmë të hiqen ose të lejohen pajisje ekuivalente, nëse nuk janë domosdoshmëri teknike.
- Semaforët, barrierat, rrethojat dhe sinjalizuesit – mund të përfshihen si një kërkesë e përgjithshme për sigurimin dhe menaxhimin e trafikut në punishte.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sektori i prokurimit ka kërkuar sqarime nga njësia kërkuese si dhe shqyrtimin preliminar të pretendimeve. Me këtë rast njësia kërkuese ka prezantuar përgjigjen si vijon: “ Ju njoftojmë se pas shqyrtimit të detajuar të dokumentacionit tenderues për projektin e sipërpërmendur, konsiderojmë se të gjitha kërkesat e parashtruara janë të arsyetueshme, konform standardeve teknike dhe plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrë parasysh rëndësinë e veçantë strategjike që ky projekt ka për infrastrukturën dhe lehtësimin e qarkullimit të trafikut në kryeqytet, theksojmë pikat kyçe si më poshtë:

- **Plani Dinamik i Punimeve:** Operatorit Ekonomik do t'i kërkohet paraqitja dhe zbatimi i një plani dinamik strikt e të detajuar, me qëllim realizimin e punimeve brenda afateve të parapara dhe me dinamikë të shtuar.
- **Menaxhimi i Trafikut:** Projekti nuk lejon bllokimin e plotë të segmentit rrugor. Ekzekutimi i punimeve duhet të fazohet në mënyrë të tillë që të garantohet vazhdimësia e lëvizjes së automjeteve pa ndërprerje totale.
- **Përputhshmëria me KRPP-në:** Këto kërkesa dhe specifikime teknike janë i nënshtruar kontrollit nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), nga i cili nuk është pranuar asnjë vërejtje apo reagim negativ, duke konfirmuar kështu rregullsinë e procedurës”.

Duke marrë parasysh pretendimet ankimore secilën një nga një, pastaj përgjigjet nga njësia kërkuese, natyrën dhe qëllimin e projektit, formulimin e kërkesave të DT dhe ST, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.08.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.